

Projekt Statuti i Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve
mbi krimet e luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të
njeriut në territorin e Jugosllavisë së dikurshme



Koalicioni për KOMRA, Grupi Punues për hartimin e Statutit të KOMRA-s, tetor 2010.

Përmbajtja

Preambula

PJESA I. – DOMETHËNIA E NOCIONEVE NË KËTË STATUT

Neni 1. – Domethënia e nocioneve në këtë Statut

PJESA II. – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 2. - Definicioni

Neni 3. - Simbolet

Neni 4. – Selia dhe Sekretariati Ekzekutiv

Neni 5. – Statusi juridik

Neni 6. – Periudha e veprimit

Neni 7. – Përfaqësimi dhe prezantimi

Neni 8. – Përdorimi i gjuhëve

Neni 9. – E drejta për dhënien e kontributit në punën e Komisionit

Neni 10. – Parimet e veprimtarisë së Komisionit

PJESA III. – OBLIGIMI PËR BASHKËPUNIM ME KOMISIONIN

Neni. 11 - Obligimi i shteteve për bashkëpunim me Komisionin

PJESA IV. – QËLLIMET DHE DETYRAT E KOMISIONIT

Neni 12. - Qëllimet e Komisionit

Neni 13. - Detyrat e Komisionit

PJESA V. – KOMPETENCAT E KOMISIONIT

Neni 14. - Kompetencat kohore dhe territoriale të Komisionit

Neni 15. – Veprat nën kompetencën e Komisionit

PJESA VI. – AUTORIZIMET E KOMISIONIT

Neni 16. – Marrja e deklaratave

Neni 17. – Grumbullimi i dokumentacionit dhe burimeve tjera

Neni 18. – Hulumtimet dhe vizitat në terren

Neni 19. – Dëgjimet publike të viktimave dhe personave të tjerë

Neni 20. – Mbajtja e sesioneve tematike

Neni 21. – Rregulloret e Komisionit

PJESA VII. – ZGJEDHJA E ANËTARËVE DHE ANËTAREVE TË KOMISIONIT

Neni 22.– Përbërja e Komisionit

Neni 23.– Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

Neni 24. – Njëjtësia e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

Neni 25. – Kandidimi i anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

Neni 26. – Përbërja dhe zgjedhja e Këshilleve seleksionues

Neni 27. – Zgjedhja e kandidatëve/kandidateve për anëtarësim në Komision nga ana e këshillit përzgjedhës

Neni 28. - Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit nga ana e kryetarit/kryesisë të shteteve kontraktuese

Neni 29. – Mbledhja konstituive

Neni 30. – Zgjedhja e kryesuesit/kryesueses dhe miratimi i Rregullores

Neni 31. – Kuorumi dhe vendimmarrja

Neni 32. – Ndërprerja e mandatit të anëtarit/anëtares së Komisionit

Neni 33. – Largimi i përkohshëm nga detyra e anëtarit/anëtares të Komisionit

PJESA VIII. – TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE/ANËTAREVE DHE PERSONELIT TË KOMISIONIT

Neni 34. – Ndërgjegjja, pavarësia dhe paanshmëria

Neni 35. – Privilegjet dhe imuniteti

Neni 36. – Mbrojtja e burimeve dhe të dhënave konfidenciale

Neni 37. - Statusi i anëtarëve/anëtareve dhe i të punësuarve në Komision

PJESA IX. – STRUKTURA E KOMISIONIT

Neni 38. – Sekretariati ekzekutiv dhe paralelet tematike të Komisionit

Neni 39. – Zyrat e Komisionit në shtetet kontraktuese

Neni 40. – Arkivi i Komisionit

PJESA X. – FINANCIMI I KOMISIONIT

Neni 41. – Financimi i Komisionit

Neni 42. – Raportimi financiar

PJESA XI. – RAPORTI PËRFUNDIMTAR I KOMISIONIT

Neni 43. – Hartimi dhe publikimi e Raportit përfundimtarë

Neni 44. – Përmbajtja e Raportit përfundimtarë

Neni 45. – Gjetjet mbi kryerësit

Neni 46. – Obligimet e parlamenteve dhe qeverive për shqyrtimin e Raportit përfundimtarë

PJESA XII. – TË NDRYSHME

Neni 47. – Veprat penale dhe sanksionet

Neni 48. – Roli i Komisionit në procedimin penal

PJESA XIII. – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 49. – Përfundimi i punës së Komisionit

Preambula

Shtetet kontraktuese

Të vetëdijshme se ngjarjet nga e kaluara e popujve në hapësirat e Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë (RSFJ) së dikurshme, dhe posaçërisht nga ngjarjet e shekullit të njëzetë, dhe mu në fillimin të shekullit njëzetënjë, janë lëndë e manipulimeve të shpeshta;

Të vetëdijshme se të dhënat kundërthënëse historike për Luftën e dytë botërore në këtë rajon janë shfrytëzuar për tu arsyetuar cikli i ri i dhunës, dhe se është e domosdoshme të pengohet që ngjarjet e viteve të njëzeta ti shërbejnë qëllimeve të tilla;

Duke përkujtuar që luftërat në territorin e RSFJ-së së dikurshme, që ndodhen në periudhën kohore nga viti 1991 gjer në vitin 2001, janë karakterizuar me përhapjen e kryerjes së krimeve të rënda e të pashprehura dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut;

Duke vërejtur se gjykimet para Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë dhe në gjykatat vendore, edhe pse kontribuojnë në dënimin e kryerësve të krimit, nuk i përmbushin, në masë të duhur, nevojën e viktimave për drejtësi, dhe as vetvetiu nuk mund të krijojnë kushte të mjaftueshme për arritjen e qetësisë së qëndrueshme në rajon;

Duke vërejtur se iniciativa rajonale, e cila potencon dialogun e hapur, hulumtimin dhe analizimin e provave (fakteve), është rruga më e mirë e të dhënave gjithëpërfshirëse historike mbi krimet të cilat janë kryer në periudhën e përmendur, si dhe për rolin e elitave nacionale, institucioneve dhe individëve në ngjarjet traumatike;

Duke shprehur keqardhje ndaj viktimave të pafajshme të të gjithë popujve në territorin e RSFJ-së së dikurshme, dhe kundërshtim ndaj keqpërdorimit të viktimave me qëllime politike dhe garat në viktimizim;

Të vendosura që në masën më të madhe të mundshme të ndihmojnë për vërtetimin e fatit të një numri të madh të individëve të cilët edhe më tutje evidentohen si të humbur (të pagjetur);

Të vendosura që bashkërisht të kontribuojnë në pranimin e provave (fakteve) mbi krimet e luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut ndaj të gjitha viktimave dhe përtëritjes së mirëbesimit në mes të individëve, popujve dhe shteteve në rajon;

Me qëllim të forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit dhe të kulturës për respektimin e të drejtave të njeriut,

Ndërsa, sa i përket periudhës kohore gjatë të cilës do të jetë në fuqi Statuti i komisionit, dua të theksoj mospërpunueshmëri e caktuara, sepse në preambulë

*shkruan se themelimi i KOMRA-së ka të bëjë me periudhën kohore prej vitit 1991 deri 2001. Ndoshta është bërë ndonjë gabim përkthim në gjuhën maqedone, por në tekstin e shkruar në gjuhën maqedone thuhet – “**deri**” do të thotë se viti 2001 nuk përfshihet në këtë periudhë.* (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Shpallin

Themelimin e Komisionit rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat e RSFJ-së së dikurshme, në periudhën nga viti 1991 deri në vitin 2001.

PJESA I. – DOMETHËNIA E NOCIONEVE NË KËTË STATUT

Neni 1.

Domethënia e nocioneve në këtë Statut

- **“Anëtari/anëtarja e Komisionit”**, është person i zgjedhur nga ana e kryetarit të shtetit kontraktues, me procedurë të paraparë në Pjesën VII të këtij Statuti;
- **”Komisioni”** është Komision Rajonal për vërtetimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në territorin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë së dikurshme (shkurtesa e emrit është: **KOMRA**)
- **“Ministri kompetent për të drejtat e njeriut”**, nënkupton ministrin/ministreshën për të drejtat e njeriut dhe të pakicave në shtetet ku një ministri e tillë ekziston, ndërsa në shtetet tjera ministri/ministresha e drejtësisë, gjegjësisht ministri/ministresha për komunitetet dhe kthim;
- **“Lufta ose forma tjetër e konfliktit të armatosur”**, nënkupton përdorimin e forcës së armatosur ndërmjet shteteve ose dhunës së vazhdueshme të armatosur ndërmjet pushtetit dhe grupeve të armatosura të organizuara, gjegjësisht ndërmjet grupeve të armatosura të organizuara brenda një shteti;
- **“Krim lufte”**, nënkupton domethënien e terminit *“krim lufte”* në të drejtën humanitare, gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit;
- **“Trupi parlamentar kompetent për të drejtat e njeriut dhe të pakicave”**, nënkupton, varësisht nga emri në shtetet e ndryshme kontraktuese, këshillet parlamentare ose komisionet kompetente për të drejtat e njeriut ose marrëdhëniet ndërnacionale;
- **“Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ)”**, është shteti që e përbënin gjashtë republika, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia, Serbia dhe dy krahina autonome; Kosova dhe Vojvodina; dhe e cila ka ekzistuar që nga 29 nëntori i

vitit 1943 deri *de facto*, në shpërbërjen e vitit 1991 në konfliktet e armatosura në Kroaci dhe Slloveni, në ndërkohë duke ndryshuar emrin e saj disa herë;

- “**Shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut**”, përfshijnë: vrasjet, robërimet, burgosjen e padrejtë, torturimin, zhdukjet e dhunshme, depërtimin dhe shpërnguljen e dhunshme të popullsisë, si dhe shkeljet tjera të të drejtave të njeriut, të parapara me Paktet Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat detyrojnë të gjitha shtetet kontraktuese, e për të cilat Komisioni vlerëson se sipas natyrës dhe pasojave kanë karakter “të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut”;
- “**Kryerësi**”, është personi i cili ka kryer veprën krim lufte, krim kundër njerëzimit, gjenocid ose vepër që paraqet në një vepër tjetër të rëndë të shkeljes e të drejtave të njeriut; Nocioni përfshinë kryerësit, bashkëkryerësit dhe pjesëmarrësit.
- “**Viktimat**” janë personat të cilët, individualisht ose në mënyrë kolektive, kanë pësuar dëme, duke përfshirë lëndime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose kufizime të konsiderueshme të të drejtave të tyre themelore përmes veprimeve ose mosveprimeve që paraqesin shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut të pranuar me të drejtën ndërkombëtare, ose shkelje të rëndë të të drejtës humanitare ndërkombëtare. Kur është e përshtatshme, dhe në përputhje me të drejtën vendore, termini viktimë, gjithashtu përfshinë edhe anëtarët e familjes së ngushtë ose personat të cilët viktimat në mënyrë të drejtpërdrejtë i ka mbajtur.

PJESA II. – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 2.

Definicioni

1. Komisioni rajonal për vërtetimin e provave (fakteve), mbi krimet e luftë dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut në hapësirat e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) së dikurshme, është Organizatë Ndërkombëtare e themeluar me këtë akt ligjor.

Cilat do të jenë gjuhët e marrëveshjes? A do të jenë të gjitha ato gjuhë të cilat i përmendëm [gjuhët zyrtare të shteteve nënshkruese]? Nëse po, atëherë kemi një problem, sepse ndonjëherë kuptimi i disa gjërave nuk është i njëjtë në të gjitha gjuhët. Në këtë kuptim unë propozoj gjuhën angleze si gjuhë neutrale, ta kemi si gjuhë shpesh. (doc. dr Milan Brglez, Fakulteti për shkencat politike, Universiteti në Lubjanë, Slloveni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Nëse ajo do të duhet të jetë organizata ndërkombëtare, atëherë ku e keni

kuvendin e shteteve nënshkruese? (doc. dr Milan Brglez, Fakulteti për shkenca shoqërore, Universiteti në Lubjanë, Slloveni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*Këtu thuhet shumë qartë se KOMRA është “organizatë ndërkombëtare e themeluar me këtë akt”. Duke i pas parasysh standardet ndërkombëtare të të drejtës për themelimin e organizatave ndërkombëtare, atëherë **statuti nuk është akti me të cilin mund të themelohet një organizatë ndërkombëtare e tillë** (...) mendoj se këtë formulim duhet lënë në formën si **marrëveshje ndërshtetërore** i cili do të ishte akt juridik me të cilin themelohet KOMRA.* (Ibro Bulić, Prokuroria e BeH, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...)versioni origjinal i tekstit do të duhej të jetë në gjuhën angleze, siç është në shumicën e marrëveshjeve ndërkombëtare. (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) Shtrohet pyetja, a mundet një organizatë ndërkombëtare të themelohet me një akt të tillë juridik? E dyta, poqese është formuar, kush e mbështetë këtë akt juridik, duke pasë parasysh se bëhet fjalë për më shumë shtete? Pra, që kjo të mund të kalojë, nëse asgjë tjetër, të kalojë, sipas mendimit tim, ratifikimin në parlamentet nacionale. (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) një organizatë ndërkombëtare mund të përcaktohet me statut, si p.sh të themi Karta e Kombeve të Bashkuara apo statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare penale. (doc. dr Milan Brglez, Fakulteti për shkenca politike, Universiteti në Lubjanë, Slloveni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Pse të mos e themelojmë një organizatë ndërkombëtare sui generis? Diçka ngjashëm siç është Interpoli. Në kuptimin, si një lëvizje nacionale për KOMRA-në, në bashkëpunim me autoritetet institucionale ekzekutive, që do të thonë një komision i tillë si një organ ndërkombëtarë. (doc. dr Milan Brglez, Fakulteti për shkenca politike, Universiteti në Lubjanë, Slloveni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

2. Shkurtesa është KOMRA.

Neni 7.

Përfaqësimi dhe paraqitja

1. Komisionin e përfaqëson dhe paraqet kryesuesi/ja i/e Komisionit.
2. Komisioni mund të vendos që ta përfaqësojë një anëtarë/re tjetër.

Mendoj se këtu do të ishte mirë të ceket se kur, në cilat raste dhe çfarë mund të jetë arsyeja që komisioni paraqet ndonjë nen tjetër, dhe kush e sjell këtë vendimin, si dhe në çfarë mënyre. (Amir Kulagić, Këshilli Koordinues për KOMRA-në, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Neni 10.

Parimet e veprimit të Komisionit

Anëtarët/anëtares si dhe personeli i Komisionit janë të obliguar që në punën e tyre të udhëhiqen me këto vlera dhe parime:

- (a) respektimi i dinjitetit njerëzor,
- (b) pavarësia dhe paanshmëria,
- (c) përkushtimi për të vërtetën,
- (d) barazia dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut,
- (e) përgjegjësia, qasja dhe të qenit të hapur,
- (f) hulumtimi me kujdes i fakteve (provave), dhe procedura e drejtë,
- (g) integritet, vendosmëri dhe përmbajtje në standardet më të larta profesionale dhe etike,
- (h) mbrojtja e veçantë e viktimave të keqtrajtimit seksual si dhe personave të cilët ishin të mitur në periudhën të cilën e përfshinë mandati i Komisionit,

për mua ky nuk është parim, për mua ky mund të jetë qëllim, mund të jetë detyrë e komisionit. (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- (i) mbrojtja e konfidencialitetit.

PJESA III. – OBLIGIMI PËR BASHKËPUNIM ME KOMISIONIN

Neni 11.

Obligimi i shteteve për bashkëpunim me Komisionin

1. Të gjitha shtetet kontraktuese janë të detyruara të bashkëpunojnë me Komisionin, dhe ti mundësojnë kryerjen e detyrave në formë efikase në përputhje me Statutin.

2. Organet kompetente të pushtetit në shtetin kontraktues, në kërkesë të Komisionit, me kohë do të sigurojnë qasje në të dhëna, duke përfshirë edhe marrjen e deklaratave nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe zbatimin e hulumtimeve në teren, përveç nëse me këtë do të shkeleshin dispozitat e shtetit kontraktues mbi konfidencialitetin e të dhënave.
3. Të dhënat, ose dokumentet, që kanë për qëllim fshehjen e veprës së kryer penale, ose që janë të drejtuara në shkelje të rënda të të drejtave themelore të njeriut, nuk konsiderohen si sekret.

Të dhënat dhe dokumentet kurrë nuk kanë asgjë për qëllim. Të dhënat dhe dokumentet janë të atilla siç janë, dhe ato mund të shfrytëzohen për fshehjen e diçkaje, etj. Pra, do të duhej të jetë ndonjë formulim tjetër. (Miroslav Alimpić, Gjkata e lartë, Novi Sad, Serbi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

4. Në rastin kur shteti konsideron që zbulimi i të dhënave të caktuara ose dokumenteve të cilat i ka kërkuar Komisioni do të jenë në kundërshtim me dispozitat mbi konfidencialitetin e të dhënave, do të ndërmerret të gjitha masat e arsyeshme me qëllim të tejkalimit të situatës kontestuese, me angazhim të përbashkët të Komisionit dhe Shtetit. Këto masa nënkuptojnë:
 - (a) Sqarimin e Komisionit lidhur me relevancën e të dhënave apo dokumenteve të cilat i kërkon;

dhe/apo
 - (b) Marrëveshjen mbi kushtet e zbulimit të të dhënave, duke përfshirë, ndër të tjera, zbulimin e pjesshëm të përmbajtjes së dokumenteve, kufizimin në publikimin e të dhënave si dhe zbatimin e masave tjera mbrojtëse mbi konfidencialitetin e të dhënave.

PJESA E IV. – QËLLIMET DHE DETYRAT E KOMISIONIT

Neni 12.

Qëllimet e Komisionit

Komisioni ka këto qëllime:

- (a) të vërtetojë faktet për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat e RSFJ-së së dikurshme, në periudhën nga 1 Janari i vitit 1991 deri më 31 Dhjetor të viti 2001, rrethanat shoqërore dhe politike të cilat

kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave dhe pasojat të cilat janë rrjedhojë e këtyre krimeve dhe shkeljeve të të drejtave;

Ti vërtetojmë faktet, ndërsa të vërtetën për fillimin e luftës, për pasojat të vërtetojë komisioni i historianëve, filozofëve apo kushdo tjetër. (dr Zdravko Grebo, Fakulteti juridik, Universiteti në Sarajevë, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- (b) të kontribuojë që elitat politike dhe shoqëritë në shtetet kontraktuese të pranojnë faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.

Termi elita, është i papërshtatshëm, do të duhej të jetë termi udhëheqësit politike. (Branislav Radulović, Shoqata e juristëve të Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Propozimi im do të ishte, si në vijim – “Të kontribuojë që shtetet nënshkruese t’i pranojnë faktet për krimet e luftës” (...) Pra, pa “elitat politike”, sepse vlerësoj se duke ua dhënë rëndësinë, thjesht po ua mundësojmë atyre elitave që akoma të vendosin për fatin tonë, ndërsa ne të mbetemi vëzhgues pasiv. (Siniša Štimac, avokat, Kroaci, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) dikush më parë i përmendi elitat politike. Edhe mua po më pengon ajo shprehje, dhe mendoj se do të ishte shprehje më e mirë, ai i cili është përdorë në preambulë, i cili thotë elitat nacionale. Ndoshta ky do të jetë term apo shprehje më e mirë, apo strukturat politike. (Miroslav Alimpić, Gjykata e lartë në Novi Sad, Serbi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- (c) të kontribuojë në ndriçimin e fatit të humburve – pagjeturve;

(...) “fati”, do të duhej të shkruhet në shumës “fatet”. (Branislav Radulović, Shoqata e juristëve të Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- (d) të pranojë padrejtësitë e shkaktuara ndaj viktimave, me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe bashkëndjenjës për viktimat;

Kjo do të duhej të veprojë në tërë opinionin e gjerë, prandaj sipas terminologjisë do të duhej të thuhet kështu – “të pranohen padrejtësitë e shkaktuara viktimave, me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe ndjeshmërisë me viktimat tjera”. (Branislav Radulović, Shoqata e juristëve të

Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

“Të pranohen padrejtësitë”, kjo rrjedhë nga vetë faktet të cilat do t’i vërtetojë komisioni, sepse në paragrafin 1, thotë – “të vërtetojë faktet”. Dhe, çfarë arrihet me pranimin e fakteve dhe kujt i referohet pranimi i padrejtësisë? A i konfirmon komisioni ato si të tilla apo do të duhet për secilin, secilit që i referohet padrejtësia, gjegjësisht çdonjëri që në ndonjë mënyrë ka bërë ndonjë padrejtësi, ta pranojë padrejtësinë, në mënyrë që të mund të shkojmë më tutje në ndërtimin e kulturës, solidaritetit, ndjeshmërisë, etj. (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- (e) të kontribuojë në realizimin e të drejtës së viktimave; dhe
- (f) të kontribuojë në pengimin e përsëritjes së krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

(...) kur bëjmë vërtetimin e fakteve dhe shkaqeve, atëherë qëllimi do të ishte mirë të shprehet në kuptimin pozitiv, e kjo është mbështetja, gjegjësisht fuqizimi, mbështetja e paqes dhe natyrisht dinjitetit dhe respektimi i të drejtave të njeriut. (Ivo Grga, avokat, Kroaci, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Sa u përket qëllimeve të komisionit (...) në vazhdim thuhet – “të kontribuojë në zbardhjen e fatit të të zhdukurve”, do të thotë fokusohet vetëm në një element, ndërsa ne kemi edhe elemente tjera, mes të cilave, siç kam thënë, shpërnguljet e dhunshme, zhvendosjet, apo gjërat tjera të caktuara, Pra, ose do të fokusohemi në të gjitha segmentet e cekura, apo do të duhej të shkruajmë diçka të përgjithshme. (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Neni 13.

Detyrat e Komisionit

Komisioni ka këto detyra:

- (a) të grumbulloj të dhëna për rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimeve të luftës, të ofrojë përshkrim të detajuar për to, dhe të pasqyrojë përmes formularëve shkeljet e të drejtave dhe pasojat e tyre;

(...) unë jam për variantin, të shkohet vetëm me krimet e luftës, sepse krimet e luftës me të vërtetë janë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. (Ibro Bulić, Prokuroria në BeH, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

“të tregojë formularët” – në gjuhën maqedone kjo nuk ka kurrfarë kuptimi (...) pastaj mundësia për arbitrim (...). (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(b) të grumbullojë të dhëna për fatin e të humburve dhe të bashkëpunojë me trupat kompetente të cilat, në shtetet kontraktuese, merren me hulumtimin për të zhdukurit;

(c) të bëjë inventarizimin e humbjeve njerëzore për:

- i. civilët të cilët kanë humbur jetën ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur; dhe
- ii. luftëtarët të cilët kanë humbur jetën, ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur;

“Regjistri i humbjeve në njerëz” mendoj se nuk është shprehje mjaft e mirë. Të regjistrohen vetëm humbjet, dhe me këtë rast të mos krijojmë personalizimin e viktimave, mendoj se nuk është humane, dhe ky nuk është mekanizmi të cilin do ta donin viktimat (...) Kështu që, unë këtu do të dëshiroja ta vendosja termin apo shprehjen “vështrimi” por me qëllim të personalizimit. (Amir Kulagić, Këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Desha ta bëj vetëm një intervenim, gjuhësor, më shumë i natyrës psikologjike, e jo ligjore. Në nenin 13, paragrafi (c), “civilët të cilët kanë humbur” mendoj se do të ishte më adekuate folja, kur flasim për viktimat të cilët janë vrarë ose vrarë. (Robert Adrić, Gjykata e Qarkut në Osijek, Zyra për mbështetje viktimave dhe dëshmitarëve, Kroaci, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(d) të grumbullojë të dhëna mbi vendet e burgosjes të ndërlidhura me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur, dhe të hartojë një regjistrim gjithëpërfshirës;

Nën paragrafin “d” – “të mblidhen të dhënat për vendet e burgimeve”, sërish po flas për tekstin e shkruar në gjuhën maqedone, e shkruar në këtë mënyrë nuk ka kurrfarë kuptimi, pra, duhet të shkruhet – “burgimi i kujt”? Pra, personat të cilët kanë qenë viktimë, apo të ceket më qartë se për kënd konkretisht këtu bëhet fjalë. (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e

njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- (e) [ALT. A: të hulumtojnë rrethanat politike dhe shoqërore të cilat drejtpërdrejtë kanë sjellë deri te shpërthimi i luftërave, ose i formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjes së krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut];
[ALT. B: Të hulumtojnë rrethanat politike dhe shoqërore të cilat, duke filluar nga viti 1980, drejtpërdrejtë kanë sjellë deri te shpërthimi i luftërave ose formave të tjera të konflikteve të armatosura, si dhe kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut];

*(...) është më e mençur dhe më përgjegjëse të mbetet në **alternativën A**, dhe të mos përcaktohet në vitin 1980, kaq rreptë, sepse atëherë shtrohet pyetja se cili është kriteri as i saktë i përcaktuar, dhe kjo pastaj hap një polemikë të madhe lidhur me këtë pjesë.* (Branislav Radulović, Asociacioni i avokatëve të Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*(...) unë jam për atë që të shkojmë më gjerë, të flasim **vetëm për shkaqet e menjëhershme, por pa kufizim kohor**.* (doc. dr Milan Brglez, Fakulteti i shkencave shoqërore, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*(...) e mbështesë propozimin që të shkohet me **alternativën A**. Që të kuptohet më lehtë pse kanë ndodhë ato gjëra të tmerrshme në këto hapësira, duhet ta shikojmë aspektin historik, shoqëroro politik, dhe mendoj se kufizimi në vitet e '80-ta, sigurisht do të ishte një periudhë e ngushtë kohore.* (Amir Kulaglic, këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Unë jam për alternativën A, por menjëherë të them se unë jam për atë që të shkohet disa vite para viti '91, pra jo para vitit '80. (Nikola Bešenski, Gjkata e Qarkut në Vukovar, Kroaci, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*(...) është shumë ambicioze të paraqitet për tu hulumtuar rrethanat paraprake politike, shoqërore të cilat kanë sjellë deri te shpërthimi i luftës. Praktikisht, kjo do të thotë të vërtetohet pse ka ndodhë lufta. Kjo është detyrë të cilën e bëjnë shumë institucione tjera, dhe **nuk di se a mundet komisioni t'ia parashtojë vetes një detyrë kaq ambicioze, dhe çfarë do të thotë vetëm të hulumtojë.*** (Miroslav Alimpić, Gjkata e lartë në Novi Sad, Serbi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- (f) të mbajë dëgjime publike për krime të luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut;
- (g) të rekomandojë masat të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e përsëritjes së shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe reparacionin për viktimat;

Mendoj se do të ishte shumë më mirë poqëse kjo do të ishte e ndarë në dy pjesë, ku do të thuhet – “të propozojë masat të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e përsëritjes së shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut; dhe pastaj qëndrimi tjetër – “të propozojë masat me qëllim të dëmshpërblimit për viktimat”. Mendoj se këto janë dy institute të cilat do të duhej të ndahen në këtë mënyrë. (Branislav Radulović, Asociacioni i avokatëve të Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) dëmshpërblimi për viktimat do të duhej të jetë nën i posaçëm, dhe ai të jetë para kësaj. (Nikola Bešenski, Gjykata e Qarkut në Vukovar, Kroaci, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- (h) të hartoj, publikojë dhe prezantojë raportin përfundimtarë.

PJESA E V. – KOMPETENCA E KOMISIONIT

Neni 14.

Kompetenca kohore dhe territoriale e Komisionit.

Komisioni vërteton faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në periudhën nga data 1 Janar 1991 deri më 31 dhjetor 2001, në shtetet në hapësirat e RSFJ-së së dikurshme, dhe hulumton:

- [ALT . A: rrethanat politike dhe shoqërore të cilat drejtpërsëdrejti kanë sjellë deri te shpërthimi i luftërave ose i formave të tjera të konflikteve të armatosura, si dhe kryerja e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut];
- [ALT – B: rrethanat politike dhe shoqërore, duke filluar nga viti 1980, drejtpërsëdrejti kanë sjellë deri te shpërthimi i luftërave ose i formave tjera të konflikteve të armatosura, si dhe kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda e të të drejtave të njeriut].

Neni 14, shumë shkurt, paragrafi 1, në mënyrë integrale përmbahet në nenin 12, paragrafi (a), ndërsa alternativat janë të përfshira në mënyrë integrale në nenin 13, paragrafi (e), thjesht janë për së tepërmi të paraqitura në të dy vendet. (Branislav Radulović, Asociacioni i avokatëve të Malit të Zi, Mali i

Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*Në parim e mbështes **variantin A**, sepse fjala paraprakisht, për mua nuk do të thotë vetëm një minutë para krismës së pushkës së parë, e cila ka filluar në hapësirat tona.* (Zlatko Kulenović, Gjykata supreme e Republikës së Serbisë, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*(...) sipas mendimit tim **alternativa A**, është më e gjerë dhe e jep mundësinë e një sqarimi më të gjerë dhe më konkret.* (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*(...) **alternativa B**, është më e qartë.* (Xhevdet Elshani, Gjykata e Qarkut në Prizren, Kosovë, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Neni 15.

Veprat në kompetencën e Komisionit

[ALT. A: Komisioni do të bëj përcaktimin e fakteve në lidhje me krimet kundër njerëzimit dhe kundër të drejtës humanitare ndërkombëtare, si dhe faktet në lidhje me shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut.].

[ALT. B: Krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave me të cilat merret Komisioni përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a. gjenocidi;
- b. dëbimi;

*(...) unë do të kërkoja nga ju që përndjekjes t'ia shtoni – përndjekja jashtë **vendit**.* (Sabit Maliqi, avokat, Kosovë, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- c. vrasja
- d. robërimi;
- e. burgosja e kundërligjshme;
- f. torturimi;
- g. zhdukjet e dhunshme;
- h. deportimi dhe zhvendosja e dhunshme e popullsisë;
- i. dhunimi dhe forma tjera të rënda të keqtrajtimit seksual;

- j. marrjen dhe shkatërrimin e pronës në përmasa të mëdha;
- k. marrja e pengjeve;
- l. shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturo-historike;
- m. shfrytëzimi i civilëve dhe robërve të luftës si “mburojë njerëzore”

*Po na paraqitet paqartësia në vërtetimin e kompetencës së komisionit. Ato ose janë krime të luftës dhe shkelje të rënda, ose janë vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare. Pra, kjo do të duhej të futet në mënyrë të qartë në të gjitha pjesët ku nevojitet. Sipas aspektit juridik, mendoj se do të ishte më mirë të përdoren shprehjet dhe termet e njohura dhe të vërtetuara deri më tani, **veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës humanitare ndërkombëtare**. Sepse, kjo përfshinë një spektër më të gjerë, ndërsa alternativa tjetër përfshinë vetëm dhjetëra lloje të veprave penale të cekura, por nuk kufizohet vetëm në to, prandaj ne mund t'i radhitim 15 sosh, dhe pastaj t'i shtojmë edhe tjerat. Prandaj, mendoj se do të ishte më e qëlluar të jetë **alternativa A**.* (Miroslav Alimpić, Gjykata e lartë në Novi Sad, Serbi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*(...) nuk jam përkrahës i radhitjes, veç e veç, siç janë paraqitur në **alternativën B**, sepse menjëherë vërehet mospërfshirja e disa formave (llojeve) të caktuara të veprave penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, përderisa është shumë e rëndësishme në vetë idenë e KOMRA-së që të përfshihen të gjitha veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, andaj mendoj se ky formulim e përmban thelbin e saj, pra **alternativa A, i përfshinë në tërësi të gjitha format e krimeve të luftës**.* (Ibro Bulić, Prokuroria e BeH, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Neni 15, paragrafi 1, neni nuk e përmend fare krimin e luftës. Fare nuk ekziston, nuk e emëron në kuadër të kompetencës, ndërsa në paragrafin 2, jepet një formulim i cili nuk është juridik – “Krimet e luftës dhe shkeljet e rënda, me të cilat merret komisioni përfshijnë, por nuk kufizohen” (...) Ai [komisioni] është një organ i cili duhet ti ketë specifikat e kompetencës së tij, prandaj ky nen duhet tërësisht të ripërpunohet. (Branislav Radulović, Asociacioni i avokatëve të Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*Zotëria Bulić, na tha se alternativa B nuk i përfshinë të gjitha veprat të cilat përfshihen në të drejtën ndërkombëtare humanitare. Unë preferoj të **mbetet alternativa B, por të shtohen veprat e krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të cilat nuk janë të përfshira apo radhitura këtu**.* (Amir Kulagić, këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) alternativa A, i ofron të gjitha mundësitë. (Nikola Bešenski, Gjykata e Qarkut në Vukovar, Kroaci, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) propozoj që në nenin 15, të mbetet alternativa B, e cila i radhitë (numëron) detyrat që janë nën kompetencat e komisionit, dhe në këtë nen të mbeten shkeljet e të drejtave të njeriut, e jo vetëm krimet e luftës. Dhe, krahas kësaj, sipas mendimit tonë, në definicionin e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, është dashur të përfshihen edhe fjalët (...) “ndalimi sistematik, arbitrarë apo i paligjshëm apo pengimi për marrjen e shtetësisë, në kuptimin e qasjes për shtetësi, apo ndalimi për të pasë të drejtën në qëndrim të përhershëm. (Neža Kogovšek, Instituti për paqe, Slloveni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) mendoj se ky kombinimi i dytë, edhe pse po duket më i saktë dhe më preciz, megjithatë është shumë më i pasaktë se sa i pari, me faktin se unë do të bëja një intervenim në kombinimin e parë. Ku thotë, se komisioni i vërteton faktet në lidhje me, do të duhej të shtohet – “me të gjitha veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës humanitare ndërkombëtare”. Dhe, pikë. Pjesa tjetër në vazhdim, e tëra është e panevojshme, kjo sipas mendimit tim, natyrisht. Përpos, nëse duam të zgjerohemi në shkeljet e gjëra të të drejtave deri te e drejta në kursime. (Munib Halilović, Prokuroria e BeH, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) të shkohet me nenin A, i cili është më gjithëpërfshirës. (Mira Smajlović, Gjykata e BeH, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) Sa i përket nenit 15, po shoh se ka shumë diskutime rreth tij. E kam bërë një kombinim, (...) “komisioni vërteton faktet lidhur me veprat penale kundër njerëzimit dhe kundër të drejtës ndërkombëtare humanitare, si dhe faktet në lidhje me shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut”, dhe tani do të shtoja – “për çfarë nuk do të duhej të kufizohej vetëm në to” dhe pastaj do ti radhis këto të tjerat. (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

PJESA VI. – AUTORIZIMET E KOMISIONIT

Neni 16.

Marrja e deklaratave

1. Komisioni merr deklaratat mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, sipas kompetencës së vet, nga viktimat, dëshmitarët, kryerësit dhe personave të tjerë, për të cilët konsideron që mund të kenë njohuri për provat (faktet) relevante.
2. Çdo person të cilit, Komisioni, ia dërgon ftesën është i obliguar që të jep deklaratë për Komisionin. Posaçërisht, viktimat nuk kanë obligim për të dhënë deklaratë pranë Komisionit për të vuajturit ose vuajtjet e anëtarëve të familjes.

Kujdes në këtë, “secili person të cilit komisioni ia dërgon ftesën, është i obliguar të japë deklaratë para komisionit” A do të mund ti vërtetojmë të drejtat dhe obligimet e personave të caktuar me statut? Të supozojmë se mundemi, shumë vështirë. Cili do të jetë sanksioni, poqëse kjo nuk bëhet? Kemi shembullin nëse bëhet fjalë për një fshehtësi, por nuk e kemi shembullin e rastit nëse ai thjesht nuk dëshiron, e nuk është fshehtësi. (Branislav Radulović, Asociacioni i avokatëve të Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Nëse ne tentojmë t'i detyrojmë njerëzit të flasin, të dëshmojnë për diçka, kjo do të jetë shumë e vështirë, sepse dëshmitari, thjesht nuk është i obliguar të përgjigjet në pyetjet eaktuara. Këtu thuhet – “secili person të cilit komisioni ia dërgon ftesën, është i obliguar të japë deklaratë para komisionit”. Më lejoni, kjo është shumë më e ashpër se sa të gjitha rregulloret penale. (...) më shumë duhet [ti] kthehem parimit të vullnetit për dhënie të dëshmisë para komisionit. Apo, të eliminohet plotësisht dënimi, apo kjo të vihet në suaza normale. Mendoj se nuk është mirë të përcaktohen veprat penale dhe sanksionet. (Miroslav Alimpić, Gjkata e lartë në Novi Sad, Serbi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Gjatë procesit gjyqësor, ju nuk do të merrni asgjë nga dëshmitari, aty ku i posedoni mekanizmat në bazë të të cilëve ai duhet të dëshmojë, nëse ai nuk dëshiron të tregojë. As për krime të luftës, dhe për asgjë tjetër. (...) Mendoj se më shumë është dashtë të shkohet me vullnetin e tyre. (Nikola Bešenski, Gjkata e Qarkut në Vukovar, Kroaci, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

KOMRA nuk duhet të ketë kurrfarë instrumentesh të presionit. Shteti përmes ligjit i ka instrumentet e presionit. KOMRA do të duhej të plotësojë atë që ligji dhe drejtësia nuk mundet, dhe këtë do ta bëjë në bazë të vullnetit, sinqeritetit, punës në terren (...) Pra, jam për atë që çdo gjë që ka instrumente të presionit, të mos vihet në statut. Kuptojeni, që secili në mënyrë individuale dhe të ndryshme e përjeton ftesën nga gjykata, ndryshe nga shoqatat apo nga organizatat joqeveritare. Akoma më shumë, nëse bëhet fjalë për punën në terren me komunitetet, ai person sigurisht do të ketë një qasje më pozitive, se sa kur e merr ftesën nga gjykata. (Mira Smajlović, Gjkata në BeH, BeH,

Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

3. Në rast se personi refuzon për ti dhënë deklaratë Komisionit, duke u thirr në detyrimin ligjor për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, zbatohen dispozitat e nenit 11, paragrafet 3 dhe 4 të këtij Statuti.
4. Dispozitat e ligjit për procedurën penale në shtetin kontraktues zbatohen në të drejtën e shkurtimit të dhënies së përgjigjes në çështjet e caktuara dhe lirimit nga detyrimi për të dëshmuar, si dhe çështje të tjera lidhur me marrjen në pyetje të personave, të cilat nuk janë të rregulluara me Statut të Komisionit.
5. Në kërkesë të dhënësit të deklaratës, Komisioni mund të mundësojë edhe dhënien e deklaratës në mbrojtje të identitetit.
6. Komisioni fton personat nga paragrafi 1 i këtij neni sipas rregullave për thirrjen e dëshmitarëve, sipas ligjeve të procedurave penale të shteteve kontraktuese në të cilat personat kanë qëndrim të përhershëm apo të përkohshëm. Në propozimin e Komisionit, Gjykata kompetente, me procedurë emergjente, vendos mbi zbatimin e masave të sigurisë për prezencën e personit, duke përfshirë edhe caktimin e dënimeve procedurale për shkak të mos përgjigjes në ftesën e Komisionit, në përputhje me ligjin mbi procedurën penale të shtetit në të cilin bëhet ftesa. Komisioni mund të lidhë, me shtetet kontraktuese, marrëveshje të veçanta për bashkëpunim me organet kompetente në procedurën e thirrjes dhe sigurimit të prezencës së personave.

*Kjo që është shkruar në nenin 6, paragrafi 16, mendoj dhe jam e bindur se është në kundërshtim, nëse jo me ligjet e tjera për veprat penale, të paktën me **Ligjin për vepra penale i cili është në fuqi dhe aplikohet në territorin e BeH.*** (Daniela Milovanović, Gjykata e Qarkut në Banja Llukë, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*(...) problemi rreth thirrjes së ndonjë personi, dhe i masave ndëshkuese në rast se ai nuk i përgjigjet asaj thirrjeje. Këtë, sigurisht do të duhej rregulluar në mënyrë që **KOMRA duhet të lidhë marrëveshje memorandumi me të gjitha organet kryesore ligjore të atyre shteteve, të cilët pastaj atë memorandum do ta inkorporojnë në statutet e tyre dhe do të lejojnë këtë mënyrë të veprimit, sepse ndryshe nuk do të mund ta tejkalojmë atë situatë.*** (Željko Horvatović, Gjykata e Qarkut në Zagreb, Kroaci, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*Neni 16, lidhur me rolin e gjykatave, mendoj se **kjo nuk ka kurrfarë gjasa që të kalojë apo të pranohet.*** Në territorin e BeH, kjo do të ishte gjykata e BeH. *Një gjykatë, të instancës gati më të lartë, e bëni shërbim të një komisioni.*

(Munib Halilović, Prokuroria në BeH, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*(...) komisioni ia jep kompetencën (juridiksionin) gjykatës. **Kompetenca e gjykatës mund të jepet vetëm me ligj.*** (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

7. Komisioni i grumbullon deklaratat:

- a. në vendbanimin apo në vendqëndrimin e dhënësit të deklaratës;
- b. në zyret e Komisionit;
- c. në ambasadat dhe konsullatat e shteteve kontraktuese, nëse kontrata merret në vendet e treta; dhe
- d. në territorin e shteteve të treta, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të atyre shteteve, dhe në rastet kur viktimat, dëshmitarët dhe personat tjerë nuk mund të japin deklaratat në konsullatat dhe ambasadat e shteteve kontraktuese.

*Kjo tanimë shkon edhe më larg, (...) pastaj shtrohet pyetja **çfarë është te ata [shtetet e treta] procedura ligjore. Atëherë, në atë situatë, a do të mund të aplikohet neni 6, paragrafi 16.*** (Daniela Milovanović, Gjykata e Qarkut në Banja Llukë, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

*(...) të shtohet kjo fjali – “**në këto raste komisioni të merret me kërkesat apo lutjet për ministrinë e drejtësisë në atë shtet nënshkrues, që shteti ta përcaktojë gjyqin përgjegjës, për vendimet që kanë të bëjnë me lutjet tona, vetëm në rastet kur nuk mund të arrihet marrëveshja me ambasadat në shtetet nënshkruese.*** (Sabit Maliqi, avokat, Kosovë, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Neni 17.

Grumbullimi i dokumentacionit dhe burimeve tjera

1. Komisioni grumbullon materiale burimore relevante të shkruara dhe elektronike, siç janë:
 - (a) dokumentacioni i institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare dhe vendore të grumbulluara me qëllim të dokumentimit të krimeve të luftës, zbulimit të kryerësve, ndriçimi për fatet e të humburve, ose për çfarëdo qëllimi tjetër;
 - (b) burimet e huaja dhe vendore të shkruara dhe elektronike, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në dokumentacionin e Qeverisë, Kuvendit, Presidencës,

- vetëqeverisjeve lokale dhe territoriale, ndërmarrjeve publike dhe private, ushtrisë, policisë, dhe shërbimeve informative;
- (c) aktgjykimet gjyqësore, transkriptet, shkresat gjyqësore dhe prokuroriale të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavinë, gjykatave dhe prokurorive nacionale në shtetet kontraktuese dhe gjykatave tjera të cilat - zhvillojnë procedura për krime lufte të kryera në territorin e ish Jugosllavisë në bazë të kompetencave universale;
 - (d) lënda tjetër arkivore-;
 - (e) burimet mediale të shkruara dhe elektronike;
 - (f) fotot, video dhe audio incizimet;
 - (g) burimet tjera lidhur me lëndën e hetimeve; dhe
 - (h) mendimet e shkruara të ekspertëve dhe përfaqësues të institucioneve, dhe organizatave të përgatitura me ftesë të Komisionit ose me vetiniciativë të autorëve.

“Komisioni mbledh burimet relevante të shkruara, elektronike dhe materiale”. Por, të gjitha këto janë burime materiale. Nuk ka elektronike, të shkruara dhe materiale, sepse të gjitha janë materiale. (Branislav Radulović, Asociacioni i avokatëve të Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

2. Në rast se personi ose organi shtetërorë refuzon të dërgojë dokumentacionin Komisionit, duke u thirrur në detyrën ligjore për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, zbatohet dispozita e nenit 11, paragrafi 3 dhe 4, i këtij Statuti.

Neni 19 .

Dëgjimet publike të viktimave dhe personave tjerë

1. Komisioni mban dëgjime publike në të cilat viktimat flasin mbi vuajtjet e tyre dhe të afërmeve të tyre.

Pse, “personat e afërm të tyre”? A nuk mund të jetë viktimë, edhe ai i cili nuk është i afërm i viktimës, por që ka të dhëna për atë person. Sa njerëz kanë vdekur së bashku, e që nuk kanë qenë të afërm mes veti, nuk kanë qenë farefis. (Branislav Radulović, Asociacioni i avokatëve të Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

2. Dëgjimet publike përfshijnë edhe kryerësit e veprave të cilët kanë karakter të krimit të luftës ose të shkeljeve të rënda e të drejtave të njeriut, dëshmitarët si dhe persona që iu kanë ndihmuar viktimave.
3. Dhënia e deklaratave në dëgjimin publik është me vullnet.

4. Me rastin e dëgjimeve publike Komisioni mund të aplikojë masa për mbrojtjen e identitetit, si dhe masa të veçanta për mbrojtje të integritetit psiko – fizik.
5. Mediet elektronike në pronësi shtetërore, gjegjësisht serviset publike, në hapësirat e RSFJ-së së dikurshme, kanë për detyrë të transmetojnë dëgjetimet publike. Mediet elektronike komerciale kanë të drejtë të transmetojnë dëgjetimet publike, nën kushte të njëjta dhe sipas rregullave të cilat vlejnë dhe për mediet në pronësi shtetërore, përkatësisht servile publike.

(...) shteti nuk mundet ti urdhëroje shërbimit publik, se çfarë të emitojë. (Branislav Radulović, Asociacioni i avokatëve të Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

6. Dëgjetimet publike mund të mbahen në lokalitete të ndryshme.

Neni 21.

Rregulloret e Komisionit

Komisioni nxjerr rregulloret e veçanta me të cilat rregullohet metodologjia unike për:

- (a) marrjen e deklaratave,
- (b) grumbullimin e dokumentacionit,
- (c) rregullimin e procedurave për dëgjime publike,
- (d) rregullimin e sesioneve tematike, dhe

Pas paragrafit (d), do të shtoja, - “rregullimi i sesioneve tematike”, si dhe propozoj të shtohet paragrafi (e) – se duhet të hartohet rregullorja për të bërë shikimin e humbjeve në njerëz.. (Amir Kulagić, këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- (e) çështje të tjera të rëndësishme për punën e Komisionit.

Neni 35.

Privilegjet dhe imuniteti

1. Me qëllim të ruajtjes së pavarësisë së Komisionit dhe veprimtarisë së tij të pa penguar, anëtarët/anëtares të Komisionit dhe të punësuarit/punësuarat në Komision, gjatë kohës së kryerjes së funksioneve të veta gëzojnë privilegjet dhe imunitetet si vijon:

- (a) imunitet nga paraburgosja dhe sekuestrimi i bagazhit personal;

Imuniteti nga burgimi, nuk është e drejtë absolute. Unë pyes, çfarë nëse ndonjëri anëtarë do të zihej në kryerje të ndonjë veprë penale. (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

- (b) imuniteti nga të gjitha llojet e procedurave ligjore në raport me mendimin e shprehur dhe veprimin, në mirëbesim, brenda kornizave të kryerjes së detyrave, dhe
- (c) përjashtimi nga çfarëdolloj kufizimi të lirisë së lëvizjes në raport me kryerjen e punëve dhe detyrave të Komisionit, dhe në raport me vajtje dhe ardhje në shtetin në të cilin kryejnë funksionin.
2. Imuniteti i paraparë me paragrafin 1, pika (b) të këtij neni, [ALT. B: në raport me shprehjen e mendimit] mbetet në fuqi edhe pas pushimit të detyrës së anëtarit/anëtares së Komisionit, gjegjësisht me përfundimin e angazhimit në Komision.
3. Komisioni ka për obligim të ndërpres imunitetin e anëtarit/anëtares dhe të punësuarit/punësuarës nëse vërteton se imuniteti do të sjell pengesa në rrjedhën e drejtësisë dhe do të rrezikojë besimin e opinionit në punën e Komisionit.

Neni 45.

Gjetjet mbi kryerësit

1. Komisioni ka autorizim që në Raportin përfundimtarë të vërtetojë se faktet e grumbulluara tregojnë për atë që personi i caktuar ka kryer krim lufte, gjegjësisht shkelje të rëndë e të drejtave të njeriut. Gjetja e tillë nuk ka efekt të aktgjykimit gjyqësor, dhe nuk paragjykon vendimin e gjykatës në rast të një ndjekje penale.

Absolutisht, mendoj se askush në këtë botë, përveç gjykatave nuk është i autorizuar, të bëjë diç të tillë, e as KB nuk mund të themelojnë një komision, të cilin do ta autorizojë të vërtetojë fajësinë individuale (...) Nëse komisioni vjen deri te të dhënat e tilla, dhe bëhet fjalë për ndonjë person të gjallë, atëherë ato të dhëna t'ia dorëzojë prokurorit kompetent, por ajo e dhënë nuk mund të hyjë në raport. (Munib Halilović, Prokuroria në BeH, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

2. Në raportin përfundimtar, Komisioni nuk mund të nxjerr gjetjet kundër ndonjë personi nëse nuk ka ndërmarr të gjithë hapat e arsyeshëm, që:

- (a) të njoftoj atë person lidhur me qëllimin e vet që të nxjerr gjetje jo të volitshme;
 - (b) ti komunikojë personit përmbajtjen e gjetjes, të dhënat në bazë të të cilave nxirret gjetja, si dhe shkaqet në të cilat është bazuar gjetja e tillë, dhe
 - (c) ti ofrojë personit mundësinë që në afat të arsyeshëm të përgjigjet në gjetjen e propozuar.
3. [ALT. A: Nga pikëpamja e rasteve të cilat janë proceduar në prezencë të akuzuarit, para Gjykatës ndërkombëtare ose vendore, Komisioni do ti referohet aktgjykimit përkatës në raportin përfundimtarë.]
- [ALT. B: Nga pikëpamja e rasteve të cilat janë proceduar në prezencë të akuzuarit, para Gjykatës ndërkombëtare ose vendore, Komisioni mund ti referohet aktgjykimit përkatës në raportin përfundimtarë.]

Neni 46.

Obligimet e parlamenteve dhe qeverive për shqyrtimin e Raportit përfundimtarë

1. Pas publikimit të Raportit përfundimtar, kryetari/kryesia e çdo shteti kontraktues, raportin ia dërgon kryetarit të parlamentit. Në afat prej një muaji pas pranimi të raportit, kryetari i parlamentit thërret seancë të veçantë të parlamentit, me qëllim të shqyrtimit të gjetjeve dhe rekomandimeve nga Raporti. Në seancë marrin pjesë një ose më shumë anëtarë të Komisionit.

Pra, bëhet fjalë për një dokument shumë serioz, prandaj për shkak të natyrës dhe çështjes së tij, ky dokument, përpos kryetarit dhe parlamentit, do të duhej t'i dorëzohet edhe avokatit kryesor shtetëror apo prokurorit kryesor, sepse ai është personi më kompetent për ndjekjen e veprave penale. (Željko Horvatić, Gjykata e Qarkut në Zagreb, gjykatës, Kroaci, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)
2. Në afat prej 6 muajsh pas publikimit të raportit përfundimtarë të Komisionit, qeveria e çdo shteti kontraktues miraton dhe publikon në gazetën zyrtare të shtetit kontraktues qëndrimin mbi zbatimin e rekomandimeve.
3. Në një afat të arsyeshëm pas përgjigjes nga qeveria sipas paragrafit 2 të këtij neni, kryetari i parlamentit në çdo shtet kontraktues thërret seancën speciale të parlamentit me qëllim të shqyrtimit të përgjigjes së qeverisë dhe angazhimit të mundshëm të parlamentit me qëllim të zbatimit të rekomandimit të Komisionit.

PJESA XII – TË NDRYSHME

Neni 47.

Veprat penale dhe sanksionet

1. Çdo person i cili:

- (a) me vetëdije jep të dhëna të rreme Komisionit, gjegjësisht personit i cili vepron në emër të Komisionit;
- (b) që me kërcënim, forcë, veprim ose premtim të përfitimeve shtyn personin tjetër për të dhënë të dhëna të rrejshme ose mos dhënien e të dhënave Komisionit,
- (c) asgjëson ndonjë dokument ose mjet me qëllim të pengimit të Komisionit që të zbaton hulumtimin, ose
- (d) të zbardhë ose në ndonjë mënyrë tjetër zbulon të dhënë të cilën e ka pranuar Komisioni me kusht konfidencialiteti (neni 36 i Statutit),

Konsiderohet se ka kryer veprë penale të dënueshme me dënim me burg deri në një vit, ose me dënim ekuivalent në të holla në shumën prej 5.000 euro.

*Këtu kemi faktin që thotë se mund të dënohet me dënim në të holla deri në vlerë 5.000 euro, por këtu mungon vlera minimale e paraparë për dënim, dhe nuk dihet se **kjo vlerë prej 5.000 euro, a është minimumi apo maksimumi i dënimit.*** (Sabit Maliqi, avokat, Kosovë, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

2. Sanksionet nga paragrafi 1 zbatohen edhe ndaj personave zyrtarë të cilët pa ndonjë arsye refuzojnë të veprojnë sipas kërkesës së Komisionit, gjegjësisht personit i cili vepron në emër të tij.
3. Në rast se personi refuzon që ti përgjigjet ftesës, ose refuzon për të dhënë deklaratë para Komisionit, zbatohen dispozitat e nenit 16, paragrafi 6 i këtij Statuti.

Nëse statuti parasheh veprë të veçantë ndëshkimi, atëherë kjo shumë vështirë do të pranohet në parlamente, sepse duhet të kemi parasysh se këtë do të duhet ta pranojnë të gjitha shtetet. (Nikola Bešenski, Gjykata e Qarkut në Vukovar, Kroaci, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

[përshkrimi i veprave penale] është diçka që fare nuk mund të ekzistojë në statut. (Daliborka Knežević, avokate, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Është paraqitë një vepër e re penale, por a ka nevojë për te? (...) të gjitha këto që po përmenden këtu, sigurisht janë inkriminuar, prandaj **[propozohet] zbatimi i ligjit penal i shteteve.** (Munib Halilović, Prokuroria në BeH, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Ne me një statut, me të cilin përcaktohet funksionimi i brendshëm i një trupi i vërtetojmë faktet e veprave penale, kjo është e pamundur (...) “Veprat penale dhe sanksionet” – kjo nuk mund të përcaktohet me këtë akt (...) Duhet të aplikohet ligji nacional për veprat penale – sanksionet ligjore në mospërgjigje dhe zbatimin sipas procedurës? **Pse të mos ekzistoj zbatimi i duhur.** (Branislav Radulović, Asociacioni i avokatëve të Malit të Zi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) gjithashtu me këtë statut nuk mund të përcaktohet se çka është vepra penale, çfarë është sanksioni dhe kush e vendos atë sanksion. Këtë, gjithashtu, duhet pasë parasysh në nenin 6. Konventa e Evropës për të drejtat e njeriut. Pse e them këtë? Nëse dikush do të dënohet në këtë mënyrë, ai sigurisht do të shkojë në Strasburg, dhe pastaj me të vërtetë është çështje e hulumtimit thelbësorë se çfarë është ky statut, dhe a është e mundur me këtë statut, dikush të dënohet në atë mënyrë, apo gjykata në esencë e merr kompetencën me statut, e jo në bazë të ligjit. (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

(...) të shënohet që të zbatohen ligjet nacionale të shteteve nënshkruese. (Sabit Maliqi, avokat, Kosovë, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)

Neni 48.

Roli i Komisionit në procedimin penal

Komisioni ka autorizime që:

- (a) të propozoj, në rast se personi për të cilin Komisioni disponon me indikacione serioze se ka kryer krim lufte ose shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, të ia komunikojë Komisionit të dhënat me rëndësi për zbulimin e lokalitetit dhe mbetjet mortore të personave të humbur, dhe/ose për zbulimin e kryerësve dhe veprave të tjera, kjo të merret nga ana e gjykatës kompetente – në rast të

procedimit – si rrethanë lehtësuese e një rëndësie qenësore me rastin e shqiptimit të lartësisë së dënimit;

- (b) ti propozoj kryerësit të gjykuar për vepër penale falje të pjesërishtme, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtetit përkatës, nëse ia komunikon Komisionit të dhënat e rëndësishme për zbulimin e lokalitetit me mbetjet mortore për persona të humbur, dhe/ose për zbulimin e kryerësve dhe veprave të tjera; dhe
- (c) të propozoj zbutje të jashtëzakonshme të dënimit për personin e gjykuar, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtetit përkatës, nëse ia komunikon të dhënat e rëndësishme Komisionit për mbulimin e lokalitetit me mbetjet mortore të personave të humbur, dhe/ose për zbulimin kryerësve dhe veprave të tjera.

*Pse do të vinte dikush, dhe të dënoje vetveten, të bëjë kallëzimin e vet penal, e pastaj të shkojë në burg. E tërë ideja (...) është që njerëzve që u bie ndërmend (...) që ndiejnë nevojë ta pranojnë mëkatin e tyre, **u ofroni diçka në këmbim**, e ai është **amnistimi**. Këtu nuk po shoh se e kemi këtë mekanizëm, (...) Çfarë garancioni kemi ne, edhe poqëse e arrijmë marrëveshjen me shtetet? (...) Çfarë garancioni kemi ne, se ata njerëz do të amnistohen? (dr Zdravko Grebo, Fakulteti juridik, Universiteti në Sarajevë, BeH, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)*

*(...) thotë se propozon **falje të pjesërishtme** dhe pastaj në fund thotë **zbutje e jashtëzakonshme e dënimit** (...) ky është **ilaçi juridik të cilin mund ta shfrytëzojë vetëm pala**. Kjo është në interesin e tij. **Komisioni mund ta mbështesë, ta shprehë mendimin e saj se kjo është diçka e mirë, etj, por nuk mund ta propozojë**. Përndryshe, çka do të fitojmë? Në njëfarë mënyre, do ta kemi një propozim, i cili do të refuzohet. Dhe, çfarë kemi bërë – asgjë. Nuk është në interes juridik, që komisioni të kërkojë diçka të tillë, por komisioni mundet, në bazë të këtyre fakteve të ketë, etj, mundësinë që të mbështesë dhe në njëfarë mënyre të ketë mendimin e saj se **pse është e nevojshme zvogëlimi apo zbutja e jashtëzakonshme e dënimit, etj**. (Margarita Nikolovska, Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me komunitetin e juristëve, Beograd, Serbi, 4 nëntor 2010.)*